



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 43/2015

Prishtinë, më 21.12.2015, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Tafa - MTI; Adriana Sejfia - GAP; Dardan Abazi – INDEP; Lejla Selimi – OSBE; Lekë Batalli – GLPS; Fjolla Uka - KDI dhe Sylejman Blaku - Kosova Sot.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 8 dhe 14.12.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Standardizim;
5. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Miratimi i rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 8 dhe 14.12.2015;

Procesverbalet e mbledhjes së datës 8 dhe 14.12.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqesë arsyetimin e Projektligjit për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe pastaj të hapet debati. Kryetari Mustafa e vlerësoi të rëndësishëm këtë projektligj, duke thënë se me këtë projektligj krijohet një pako e masave nga sfera e investimeve të jashtme dhe ky është një moment i ri në këtë sferë dhe falënderoi ministrinë dhe Qeverinë për këtë iniciativë ligjore.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është procedimi i përshpejtuar i pakos legislative dhe reformës administrative në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor. Qëllimi i këtij projektligji është që të rritet mundësia e investimeve të huaja, potencoi znj. Bajrami. Pastaj, në mënyrë kronologjike ajo njoftoi se çka përmban dhe cilat sfera i përfshinë Projektligji për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është procedimi i përshpejtuar i pakos legislative dhe reformës administrative, në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor. Aktualisht, institucionet e Republikës së Kosovës kanë vështirësi të shumta për të nxitur dhe tërhequr investimet strategjike vendore dhe të huaja. Këto vështirësi janë si pasojë e procedurave të pafavorshme, të gjata dhe të komplikuar për realizimin e investimeve të huaja në Kosovë dhe procedurave të komplikuar për bartjen e të drejtës të shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj. Vendet fqinje me të cilat Republika e Kosovës është në garë të drejtpërdrejt për tërheqjen e investimeve të huaja, kanë legjislacion më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për bartjen e pronës shtetërore tek investitorët e huaj. Kjo për shkak se legjislacioni i vendeve fqinje të Kosovës parasheh procedura më të thjeshta për bartjen në shfrytëzim të pronës shtetërore tek investitorët e huaj dhe atë me çmime simbolike, dhe pa pasur nevojë për hapjen e procedurave tenderuese. Pasi ky ligj do të hyjë në fuqi, legjislacioni i Kosovës i ndërlidhur me investimet strategjike do të përafrohet me legjislacionin e vendeve tjera fqinje në regjion dhe njëkohësisht do të eliminohen pengesat për tërheqjen e investimeve të huaja. Objektivi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për nxitjen dhe mbështetjen e investimeve strategjike të huaja në Kosovë, në fushat që paraqesin potencial të lartë zhvillimor. Përmes këtij projektligji përcaktohen procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese, në funksion të arritjes së qëllimit kryesor për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës. Ky projektligj do të zbatohet për të gjitha investimet strategjike, që përzgjidhen si të tilla në bazë të

kritereve dhe sipas procedurave të përcaktuara në të dhe në ata sektorë ekonomikë si sektorë të investimeve strategjike. Nëpërmjet stimulimit të investimeve strategjike, do të mobilizohet kapitali financiar, i cili do ta mbështes zhvillimin e veprimtarisë prodhuese sipas sektorëve të përcaktuar me këtë projektligj. Me këtë projektligj trajtohen kriteret për përcaktimin e një investimi strategjik, si vlera e përgjithshme e investimeve, hapja e vendeve të reja të punës, ofrimi i teknologjive të reja për të rritur konkurrimin dhe efektivitetin e investimeve, rritja e nivelit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e mjedisit dhe konsumatorit. Me këtë projektligj themelohet Komisionit Ndërmnistror për Investime Strategjike, si organ për negocimin, lidhjen dhe shkëputjen e marrëveshjeve për investime strategjike. Ky Komision kryen veprime të cilat kanë për qëllim pranimin dhe identifikimin e projekteve për investime strategjike, i ofron Qeverisë rekomandime në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha aktivitetet që lidhen me tërheqjen e Investimeve të huaja përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe ofron rekomandime për negocimin, lidhjen dhe shkëputjen e marrëveshjeve për investime strategjike. Që një subjekt investues të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me Qeverinë e Kosovës, subjekti investues duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet të cilat janë parapare për kualifikimin e investimeve si investime strategjike. Gjithashtu, ky ligj hap mundësitë që Republika e Kosovës të hyjë në negociata me shtete apo organizata ndërkombëtare, në bazë të cilave mund të përcaktohen kushtet tjera (përveç atyre të parapara me këtë ligj). Gjatë hartimit të projektligjit janë konsultuar të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë: Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Integritetit Evropian, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, janë konsultuar edhe rekomandimet e dhëna nga Banka Botërore dhe Zyra e Bashkimit Evropian, po ashtu, janë konsultuar edhe grupet e tjera të interesit siç janë organizatat e biznesit, odat ekonomike dhe grupet e tjera të interesit. Ky projektligj është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren për Punën e Qeverisë së Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe tërheqjen e investimeve strategjike në Kosovë, propozojmë që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë projektligj, tha në fund znj. Hikmete Bajrami.

Kryetari i Komisionit, e vlerësoi shumë të rëndësishëm këtë projektligj, sepse më anë të këtij projektligji nxiten investimet e jashtme. Ai potencoi se investimet e jashtme viteve të fundit kanë shënuar rënie, ndërsa këtë vit ka rritje. Prandaj, është me rëndësi që Republika e Kosovës të përmirësojë imazhin, që pastaj të kemi investime nga kompanitë që kanë “Brand” të caktuar me imazh të lartë. Ai tha që praktikisht duhet të shohim se cilat kompani mund të jenë investitorë strategjikë, pasi që kemi të bëjmë me asete publike, që i tërheqin këto investime strategjike. Andaj duhet të verifikohen mirë kompanitë që kanë një Brend dhe në transaksionet biznesore nuk kanë veprimtari të jashtëligjshme. Ne duhet të definojmë me ligji qartë se kush mund të jenë investitorë strategjikë. Ne nenin 2, ku flitet për fushën e zbatimit, tha se kemi shumë sektorë të ndarë, por që munden të përfshihen në një sektor të përbashkët të gjithë sektorët e industrisë dhe duhet të përkufizojmë profilin e investitorit strategjik, se cilat kritere duhet t'i kemi në përmbushjen e kushteve për të qenë investitor strategjik, dhe më rëndësi është që investitori të ketë një imazh të mirë gjatë veprimtarisë së të bërit biznes.

Blerim Grainca, e përgëzoi ministren Bajrami për Projektligjin për Investimet Strategjike, pasi që është një nevojë e domosdoshme për të lehtësuar nxitjen e investimeve të huaja. Ai potencoi se projektligji përmban vlerat minimale dhe maksimale të investimeve dhe propozoi që të ulen

vlerat minimale, pasi që janë shumë të larta, vështirë janë të përballueshëm nga investitorët, p.sh. investimet në fushën e turizmit janë vlera të mëdha për t'u investuar. Për procedurat në nenin 6, për marrjen e statusit në investimet strategjike, kërkoi që afatet të shikohen edhe një herë që të mos ketë procedura burokratike.

Besim Beqaj, tha se projektligji për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, është i nevojshëm dhe ne si Komision funksional do ta trajtojmë me shumë seriozitet. Ai theksoi se projektligji, së pari duhet të identifikohet dhe të definohet qartë, se cila dhe kush nga kompanitë mund të jenë investitorë strategjikë. Në nenin 20, te projektet strategjike të përgatitura nga Autoritetet Publike, ku thuhet “mund të krijohet lista e projekteve strategjike”, z.Beqaj propozoi që të thuhet “duhet të krijohet lista e projekteve strategjike”. Ndërsa, sa i përket prokurimit publik, ne tha ai, po heqim dorë nga procedura e prokurimit publik, por ne po japim në shfrytëzim resurset publike. Po ashtu, në nenin 4, të kriteri për përzgjedhjen e projekteve për investime, tha se është sektori strategjik ku ne po ju japim të drejtën përfitimit të projektit për me u realizua, por nëse nuk realizohet projekti atëherë çka do të bëhet edhe këtë duhet të e sqarojmë në ligj. Duhet sqaruar çka është sektori strategjik, kush është investitori strategjik, cilat janë pasojat nëse nuk arrijnë t'i bëjnë investimet, a parashihet vendim i Qeverisë, ndërsa z.Beqaj nuk u pajtua me strukturën e listës së përcaktimit të sektorëve strategjikë. Ne e përkrahim këtë projektligj për të hapë rrugë, por jo të hapë rrugë për gjithçka.

Fatmir Rexhepi, tha se objektivat që i ka parapa projektligji për investimet strategjike janë modele të mira por që duhet të japin efektin në praktikë. Pajtohem që nuk duhet të ngutemi sikurse me modelin e privatizimit, por tani për këtë projektligj, para se ta miratojmë, duhet ta analizojmë mirë deri në detaje, deri në variantin përfundimtar, të analizojmë cila është praktika dhe modeli më i mirë për ta zbatuar në praktikë, kategorizimet, vlerat dhe modelet e kategorizimeve të sektorëve strategjikë të tjerë, potencoi z.Rexhepi. Të kërkohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të na sjellë një listë se çka ka mbetur pa u privatizuar dhe të shohim realisht se çka mund t'ju ofrojmë investitorëve, theksoi në fund z.Rexhepi.

Raif Qela, tha se projektligji për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, ka qenë më se i nevojshëm. Nuk është vetëm Ligj i Prokurimit Publik, që ka penguar investimet e huaja, por ka pas edhe probleme tjera në aspektin e procedurave ligjore të stërzgjatura burokratike, që kanë shkaktuar dilema deri më tani për investitorët e huaj për të investuar në Republikën e Kosovës. Ai theksoi se sa i përket materies së Projektligjit për Investimet Strategjike, ne si Komision funksional në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i shqyrtojmë kriteret dhe të analizohen të gjitha argumentet deri në detaje, për dhënien e statusit një kompanie si investitor strategjik.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi disa çështje që u ngritën nga anëtarët e Komisionit. Lidhur më atë se nëse investitori strategjik nuk e realizon projektin, tha se me plotësim - ndryshimet juridike, kjo çështje do të rregullohet. Ajo u pajtua që projektligji duhet të jetë më i fokusuar, por Projektligji për Investimet Strategjike nuk ka qenë i lehtë të draftohet, pasi që është filluar nga pika zero, theksoi ministrja znj.Bajrami. Arsyeja pse i kemi futur të gjithë sektorët është se kemi dashur të mos mbetet ndonjë fushë e papërfshirë, ku mund të ketë investime, sqaroi znj.Bajrami. Vendosja e kufijve për investime është konsideruar si shumë e lartë. Kemi vendosur industrinë e ushqimit sepse Qeveria ka subvencionuar

mjaftueshëm në këtë fushë. Se sa kemi pasur interesim nga investitorët, tha që kemi pas interesim për të investuar, por deri më tani dihet që të gjitha pronat shoqërore kanë qene në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe në momentin që ju thuhet investitorëve që duhet të konkurrojnë, ata po largohen. Për vlerat minimale dhe maksimale që duhet të investojnë investitorët, tha që, ne nuk kemi dashur t'jua hapim derën të gjitha kompanive që nuk janë serioze në treg. Se kush duhet të jetë investitor strategjik, tha që ne kemi paraparë që një komision ndërministrorë të shikojnë profilin e kompanive për çdo investitorë të mundshëm. Është Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), që do t'i shikojë procedurat dhe komisioni ndërministrorë pastaj të shqyrtojë profilin e investitorit, mandej i rekomandon Qeverisë dhe i gjithë procesi do të jetë transparent. Për afatin prej 30 ditëve për procedurat e marrjes së statusit në investimet strategjike, tha që është një afat i mirë, pasi që nuk mund të ketë pritje të gjata. Në fund kërkoi që këshilltari i saj ligjor, z.Besim Tafa, të ftohet në mbledhjet e grupit të punës gjatë amendamentimit të Projektligjit për Investimet Strategjike, për të arsyetuar dhe për të dhënë sqarime.

Besim Tafa, këshilltar ligjor nga Ministra Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi nenin 14, lidhur më “Revokimin e vendimit për dhënien e statusit projekt strategjik dhe shkëputjen e marrëveshjes”. Ky tha se Komisioni ndërministrorë, kur merr dëshmi të reja në bazë të të cilave konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për dhënien e statusit të investimit strategjik, atëherë Qeveria e revokon vendimin për dhënien e statusit për investim strategjik.

Besim Beqaj, tha se projektligji për investimet strategjike është shumë sipërfaqësor, nëse i japim 6 muaj për të filluar projektin investitorit dhe në qoftë se nuk e fillon atëherë, duhet të sanksionohet me ligj, ndërsa sa i përket sektorëve ekonomikë, që do të përfshihen në investime strategjike, ai propozoi që të ristrukturohen sektorët dhe të fuzionohen sektorët e përafërt, fjala vjen: sektori i sportit dhe rekreacionit të fuzionohet me sektorin e turizmit, telekomunikacioni me teknologjinë industriale, bujqësia e me industrinë ushqimore, në sektorin e bujqësisë mund të hynë industria e ushqimit dhe në sport mund të hyjë turizmi.

Besim Tafa, këshilltar ligjor nga Ministra e Tregtisë dhe Industrisë, tha gjatë fazës së hartimit të projektligjit për investimet strategjike, janë studiuar modelet dhe mënyrat e privatizimit nga vendet e rajonit, për t'i pranuar praktikat më të mira, sepse çdo gjë është praktikë edhe që mund të negociohen me investitorët strategjikë.

Kryetari i Komisionit, tha se pas një diskutimi mjaft përmbajtjesor, po dalim me konkluzionet që Qeveria duhet të bëjë një listë të projekteve vitale që janë urgjente dhe strategjike për vendin, për të mundësuar kushte për investime. Po ashtu, Qeveria mund të negociojë më gjithë investitorët që janë të interesuar për të investuar në Kosovë. Kërkoi që gjatë dy leximeve, grupi i punës të ftojë edhe Zyrën ligjore për t'u konsultuar për aspekt ligjore. Po ashtu, z.Mustafa potencoi se do të shikohen mundësitë që në grupin e punës të komisionit, të angazhohet një ekspert gjatë fazës së shqyrtimit të projektligjit për investimet strategjike. Në fund kryetari Mustafa tha se e përkrahim në parim projektligjin, dhe dilemat që dolën nga diskutimi të trajtohen me kujdes gjatë fazës së shqyrtimit mes dy leximeve.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- 1. Miratohet në parim projektligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*
- 4. Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas miratimit në parim nga Kuvendi, do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Fatmir Rexhepi dhe Enver Hoti anëtarë.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Standardizimin;

Kryetari Muhamet Mustafa, tha se në bazë të Planit të punës të Komisionit për vitin 2015, kemi vendosur që të mbikëqyrim zbatimin e ligjit për Standardizimin. Grupi punues i kryesuar nga deputeti z.Fatmir Rexhepi, ka realizuar aktivitetet lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë dhe Komisionit ia kanë dorëzuar raportin me rekomandime. Ne e kemi marrë raportin e grupit punues, ku shihet, se grupi punues, ka bërë një aktivitet domethënës në bazë të planit të veprimit dhe agjendës dhe na ka sjellë për shqyrtim në Komisionin Raportin me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Standardizim dhe më pas ia dha fjalën z. Fatmir Rexhepi, që të bëjë prezantimin e raportit me rekomandime.

Fatmir Rexhepi, tha se konform vendimit që ne në Komision e kemi marrë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Standardizimin, kemi filluar punën fillimisht duke kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) dhe Departamenti Ligjor, të raportojnë lidhur me zbatimin e ligjit për Standardizimin. Grupi i Punës, ka organizuar dhe ka realizuar dëgjim publik për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, më 23 nëntor 2015, ku ishin ftuar institucionet, grupet e interesit që atakohen nga ky ligj, si odat ekonomike dhe shoqatat e bizneseve, bizneset, shoqëria civile etj. Për të parë se sa është i zbatueshëm apo në çfarë mase zbatohet ky ligj, Grupi Punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, gjatë takimeve me institucione dhe grupe të interesit, është informuar se në përgjithësi ligji për standardizimin është i zbatueshëm dhe Ministria ka bërë një punë të mirë në adaptimin e standardeve. Megjithatë, gjatë takimeve me palë të interesit është vërejt se mungon informimi i bizneseve, lidhur me shërbimet që ofron Agjencia Kosovare e Standardizimit. Nga aktivitetet mbikëqyrëse, grupi punues është informuar se AKS-ja ka adoptuar rreth 8.400 standarde, ndërsa rreth 850 standarde ka arrit t’jua plasojë palëve të interesuara që do të thotë se ka nevojë për më shumë promovim të standardeve, theksoi kryesuesi i grupit punues z.Rexhepi. Në fund z.Rexhepi theksoi se grupi punues pas përfundimit të aktiviteteve ka përgatitur raportin e

mbikëqyrjes, në të cilin janë përfshirë aktivitetet, të gjeturat dhe rekomandimet, të cilat sot i paraqiten anëtarëve të Komisionit.

Kryetari Muhamet Mustafa, theksoi se standardet kanë rëndësi esenciale që të eksportojmë, dhe pyeti se a ka Agjencia kapacitete të mjaftueshme për promovimin dhe certifikim e standardeve.

Fatmir Rexhepi, sqaroi se konsideron që Agjencia ka kapacitete të mjaftueshme për adaptim, hartim dhe promovim të standardeve, ndërsa në certifikim janë implikuar edhe departamente tjera.

Raif Qela, tha që në grupin e punës kemi diskutuar mjaftë dhe është hartuar raporti të cilin e paraqiti z. Rexhepi, dhe pajtohem që të miratohet Raporti me Rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Standardizim.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, miratoi raportin me këto

R E K O M A N D I M E

1. *Qeveria e Republikës së Kosovës ta ndryshojë dhe ta plotësojë Ligjin për standardizim.*
 - *Me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për standardizimin, AKS-ja të autorizohet që të adoptojë standarde edhe në fushën e telekomunikacionit (ITU), si dhe të rregullohet edhe mbikëqyrja e aplikimit të standardeve.*
2. *Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), të angazhohen maksimalisht që AKS-ja të anëtarësohet në mekanizmat evropianë dhe ndërkombëtarë të standardeve CEN/ CENELEC dhe ISO/IEC.*
3. *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe AKS-ja, të rrisin promovimin e standardeve të adoptuara nacionale dhe të bashkëpunojnë me komunitetin e biznesit në aplikimin e standardeve, në reduktimin e barrierave teknike, si dhe të lehtësojë në njohjen e produkteve kosovare në tregun ndërkombëtar.*
4. *AKS-ja, të përcaktojë prioritete se cilat standarde nga mbi 16000 (ISO) duhet hartuar dhe adoptuar, në mënyrë që ato standarde të cilat kërkohen nga bizneset vendore, të hartohen dhe të adoptohen me prioritet.*
5. *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ngritë kapacitetet dhe kompetencat e stafit dhe përgjegjësve të këtij sektori në mënyrë që ata t'u përgjigjen nevojave të avancimit të procesit të certifikimit lidhur me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe të rishikojë organogramin për ndryshime në sektorin e akreditimit, për të certifikuar kompanitë të cilat ofrojnë shërbime të inspektimit dhe pajisjes me certifikatë*

të konformitetit për bizneset kosovare, që pretendojnë se ofrojnë shërbime në pajtim me standardet ISO dhe IEC.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.03/L-144 për Standardizimin.

4. Të ndryshme.

Çështje vijuese

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Njësia për Mbështetjen e Komisionit, e ka hartuar raportin e punës për vitin 2015, duke u bazuar në aktivitetet e shumta që ka pas komisioni gjatë vitit 2015. Me këtë rast, kryetari Mustafa paraqiti në formë statistikore aktivitetet dhe punët e realizuara të Komisionit gjatë vitit 2015. Një çështje që mbetet për vitin në vijim është takimi me Agjencinë e Statistikave, ku do të diskutohet për statistikën ekonomike, ndërsa në fillim të vitit ardhshëm, duhet të diskutojmë për metodologjinë dhe formën e punës që do ta ndjekim potencoi z. Muhamet Mustafa.

Pas debatit, Komisioni vendosi që raporti i punës së Komisionit për vitin 2015, të shqyrtohet në mbledhjen e parë të vitit të ardhshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa